



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe neni 40 paragrafi 3 dhe neni 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të marë nga parashtrues i panjohur në vazhdimin e seancës së 51-të, të mbajtur më 01.09.2021, morri vendimin vijues:

### Vendim

Denoncimi me numër 12-4702/1 nga 08.10.2019, dorëzuar nga parashtrues i panjohur, REFUZOHET.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK nuk elemente për veprim të mëtejshëm në lëndën me numër 12-4702 të vitit 2019.

Lënda me numër 12-4702 nga 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së me arsyetim në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga miratimi i të njëjtës.

### Arsyetim

Lënda me numër 12-4702 nga viti 2019 e formuar sipas denoncimit nr. 12-4702/1 nga viti 08.10.2019 dorëzuar në KSHPK nga parashtrues i panjohur.

Në denoncimin e dorëzuar janë nxjerrë pohime kundër Kryetarit të komunës -----, -----, për dyshime për arritje kundër ligjore të shfrytëzimit të pronës, për keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe evazionit fiskal.

Parashtruesit e denoncimit dyshojnë se personi i përmendur me qëllim e keqpërdori pozitën e tij zyrtare, në kundërshtim me Ligjin për ndërtim ndërtoi shtëpi banimi në tokën e PK----- e regjistruar në IL----- për KK-----, në komunën ----- e cila tokë në Kadastrën të patundshmërisë që lidhen me personin e denoncuar, me qëllim që të respektohet ligji në mënyrë të barabartë për të gjithë.

Gjatë realizimit të kontrollit nga ana e KSHPK-së u konstatua si më poshtë:

1) toka e theksuar në denoncimin e dorëzuar është e regjistruar në kadastrën e patundshmërisë me të drejtën e regjistruar të pronësisë të personit ----- nga-----;

2) KSHPK më parë ka vepruar sipas lëndës së formuar në lidhje me personin e denoncuar dhe atë:  
- në vitin 2014, sipas lëndës së formuar pas përfundimit të miratuar për kontrollimin e të dhënave nga listat anketuese të personave të cilët për herë të parë janë zgjedhur në pozitën Kryetar komune pas zgjedhjeve të mbajtura lokale në vitin 2013, kurë ishte konstatuar se personi i emëruar dorëzoi listë anketuese me të dhëna për gjendjen pronësore pas zgjedhjes Kryetar komune dhe se pas krahasimit të të dhënave nga lista anketuese me të dhënat e marra nga institucionet kompetente (AREC, CR dhe CDHV) për personin e denoncuar dhe babanë e tij -----, të dhënat përputhen, gjegjësisht personi që nuk e paraqitur personin e emëruar në listën

anketuese nuk është identifikuar, pas së cilës është arritur në përfundimin se KSHPK nuk ka elemente për vendosje të mëtejshme kompetente në rastin konkret;

Gjatë shqyrtimit të denoncimit të dorëzuar, KSHPK konstatoi se sipas pohimeve në lëndë për personin e denoncuar për arritje të pasurisë, KSHPK tashmë ka vepruar dha ka miratuar konkluzion/vendim nga kompetencat e tij, ku vlerësoi se veprimi i mëtejshëm për këtë lëndë është i pakuptimtë, KSHPK nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtejshëm në rastin konkret, lënda e denoncimit të refuzohet, ndërsa lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**  
**Kryetar,**  
**Biljana Ivanovska**

Dorëzuar deri:  
- Arkivi

Punoi: J:C,  
Miratoi: Mr.V.G, anëtarë i KSHPK-së

